

VENDIM
Nr. 93, datë 6.2.2013

PËR HAPJEN E PIKËS SË PËRBASHKËT TË KALIMIT KUFITAR NË GRABON TË RRETHIT TË MALËSISË SË MADHE DHE TË PIKËS SË KALIMIT NDËRKUFITAR NË ÇEREM TË RRETHIT TË TROPOJËS, NË KUFIRIN SHTETËROR TOKËSOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME MALIN E ZI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 45/2012 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi “Për përcaktimin e pikës së përbashkët të kalimit kufitar “Zatrijebacka Cijevna-Grabon”, për trafikun ndërkombëtar të pasagjerëve dhe pikën e kalimit kufitar “Çerem-Vranic”” dhe të nenit 15 të ligjit nr. 9861, datë 24.1.2008 “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar në Grabon të rrethit të Malësisë së Madhe, në kufirin shtetëror tokësor të Republikës së Shqipërisë me Malin e Zi, për qarkullimin ndërkombëtar të shtetasve dhe autoveturave.

2. Hapjen e pikës së kalimit ndërkufitar (lokale) në Çerem të rrethit të Tropojës, në kufirin shtetëror tokësor të Republikës së Shqipërisë me Malin e Zi, për qarkullimin lokal të shtetasve.

3. Ngarkohet Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha